

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “ARBOR GROUP” Sh.p.k. & “PLURAL” Sh.p.k. & “Pro & Co Group” Sh.p.k. – Kamenicë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	19.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **17.08.2020**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “ARBOR GROUP” Sh.p.k. & “PLURAL” Sh.p.k. & “Pro & Co Group” Sh.p.k. me adresë në Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETËRVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E PARË**, me Numër të prokurimit: 623-20-2870-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-021-5-1-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “ARBOR GROUP” Sh.p.k. & “PLURAL” Sh.p.k. & “Pro & Co Group” Sh.p.k. me adresë në Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETËRVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E PARË**, me Numër të prokurimit: 623-20-2870-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-021-5-1-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **12.08.2020**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **TRAJTIMI I SHITRETËRVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E PARË**, me Numër të prokurimit: 623-20-2870-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-021-5-1-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “ARBOR GROUP” Sh.p.k. & “PLURAL” Sh.p.k. & “Pro & Co Group” Sh.p.k. me adresë në Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETËRVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E PARË**, me Numër të prokurimit: 623-20-2870-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-021-5-1-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 12.08.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 17.08.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE:

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me **Nenin 6, paragrafi 7.3 dhe 7.4 – Informacione Sekrete të Biznesit dhe Qasja në Dokumentacion – Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe pika 3 e nenit të 10 të Ligjit të Prokurimit, ne momentin që nuk na është dhënë mundësia të kemi qasje të shpejt dhe të arsyeshme në dokumentacionin e ofertave të dorëzuara për projektin e lartpërmendur.**

Pretendimet juaj ankimor është i pabazuar, pasi që fillimisht jeni njoftuar me email, duke cekur se: *Ju mund të keni qasje kur ju dëshironi nga dita e sodit me date: 13.08.2020 dhe çdo ditë pune, nga ora: 08:00 h deri ne: 16:00 h, në Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit.*

Ditën që keni kërkuar të keni qasje në dokumentacion asnjë zyrtar i prokurimit nuk ka qeni i lire (*pasi që kemi hapjen e ofertave, vlerësimin e tenderëve dhe takimet tjera obligative*), të ju ofroj qasje në dokumentacion, informatën të cilën ju kemi dhënë dhe gjithashtu ju kemi ftuar ditëve tjera për qasje në dokumentacion deri në afatin e lejuar për informata.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundet të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit